



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 149, datë 09.11.2020

“PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 81, DATË 27.07.2020 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA GRANTI I RIKONSTRUKSIONIT”, VENDIMIN NR. 82, DATË 27.07.2020 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT” DHE NË VENDIMIN NR. 98, DATË 04.09.2020 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA GRANTI I RIKONSTRUKSIONIT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 112, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, si dhe në vijim të shkresave me nr. 34777 prot., datë 09.10.2020 nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, shkresës me nr. 36618 prot., datë 22.10.2020 nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale si dhe Memos me nr. 39028, datë 06.11.2020 me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimet e listave të përfituesve nga granti i rikonstruksionit dhe programi i rindërtimit bëhen këto ndryshime:

1. Në vendimin nr. 81, datë 27.07.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit”, bëhet ndreqja e gabimit material si më poshtë:
 - a. Për përfituesin Petrit Rizvan Rizvani, me nr. rendor 92, Njësia Administrative nr. 6, Shkalla “DS3” e dëmit, zëvendësohet me nivelin “DS1” të dëmit.
2. Në vendimin nr. 82, datë 27.07.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit”, bëhet ndryshimi si më poshtë:
 - a. Përfituesi Naim Bleta, me nr. rendor 133, Njësia Administrative Ndroq, hiqet nga lista e subjekteve përfituese, të programit të rindërtimit nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja.
3. Në pikën 2, të vendimit nr. 98, datë 04.09.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit”, në të cilën është përcaktuar lista me 1500 përfitues bëhet ky ndryshim:

a. Kolona nr. 8 e listës së përfituesve, me emërtimin “Leternjoftim-ID”, zëvendësohet me kolonën me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU